

UDHËZIM
Nr.9, datë 29.1.2009

MBI ZBATIMIN E VENDIMIT TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR.52, DATË 14.1.2009
“PËR CILESINË E LËNDËS DJEGËSE GAZOIL (DIEZEL) TË RAFINUAR NGA
PRODHIMI I NAFTËS BRUTO TË NXJERRË NË TERRITORIN E REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË DHE TREGTUAR PËR AUTOMJETE RRUGORE DHE GJENERATORË”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 5 të nenit 10 të ligjit nr.8897, datë 16.5.2002 “Për Mbrojtjen e Ajrit nga Ndotja” dhe neneve 8 dhe 9 të ligjit nr.9121, datë 28.7.2003, “Për Mbrojtjen e Konkurrencës” të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.52, datë 14.1.2009 “Për cilësinë e lëndës djegëse gazoil (diesel) të rafinuar nga prodhimi i naftës bruto të nxjerrë në territorin e Republikës së Shqipërisë dhe tregtuar për automjete rrugore dhe gjeneratorë”, Ministri i Financave dhe Ministri i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës

UDHËZOJNË:

1. Në zbatim të pikës 8 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.52, datë 14.1.2009, subjektet importuese të lëndës djegëse gazoil (diesel), që në nomenklaturën e mallrave përshkruhet në kodin 27101945 dhe që plotëson kërkesat e standardit SSH 31:1997 ose të standardeve të tjera, të barazvlefshme me të, do të lejohen të importojnë vetëm kur paraqesin në organin doganor dhe në Inspektoratin Qendror Teknik, kontratën e shitjes, me përdoruesit, ku është specifikuar destinacioni i përdorimit në Shqipëri, për sasinë e produktit që importojnë, destinacion, i cili duhet të jetë i ndryshëm nga tregtimi për përdorim në automjete rrugore dhe gjeneratorë. Organi tatimor, në mënyrë periodike, bën verifikimin e përdorimit, sipas kontratave dhe destinacionit, dhe informon Inspektoratin Qendror Teknik.

2. Organi doganor do të kryejë procedurat për hedhjen në qarkullim të lirë të lëndës djegëse gazoil (diesel) që në nomenklaturën e mallrave përshkruhet në kodin 27101945 dhe që plotëson kërkesat e standartit SSH 31:1997 ose të standardeve të tjera të barazvlefshme me të, pasi të jetë marrë konfirmimi zyrtar nga Inspektoriati Qendror Teknik, (IQT) për lejimin e importit, vetëm për ato subjekte, të cilat përmbushin kriteret e përcaktuar në këtë udhëzim, sa më poshtë:

a) Depozitojnë pranë Inspektoriatit Qendror Teknik (IQT) kontrata të shitjes me përdoruesit, me destinacion të ndryshëm nga përdorimi për automjete rrugore dhe gjeneratorë;

b) E gjithë sasia e importuar, denatyrohet dhe ngjyroset sipas standartit të BE-së (Solven Yelløe 124, me emër shkencor N- etil-N – [2-[1-(2-isobutossierossi) etil] -4 – (fenilazo) aniline). Niveli i ngjyrit duhet të jetë jo më pak se 6 mg/l gazoil dhe jo më shumë se 9 mg/l. Ngjyrosja është detyrim i subjektit importues dhe mund të kryhet si pranë prodhuesit ashtu edhe në kalatën e portit apo vendndodhje tjetër, konform procedurave doganore në fuqi, në prezencën e inspektorit/eve të IQT dhe të doganierit/eve (përveçse kur ngjyrosja kryhet në ambientet e prodhuesit). Inspektorët e IQT, konform ligjit, kryejnë procedurat e marrjes së mostrave dhe analizës së mallit.

3. Inspektorati Qendror Teknik në zbatim të kushteve të mësipërme, lëshon një vërtetim konfirmimi për subjektin importues, një kopje e të cilit, së bashku me kopje të kontratës, i përcillet Degës Doganore përkatëse. Gjithashtu, kopje e kontratës i përcillet edhe Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve. Afati i kryerjes së procedurave (nga momenti i dorëzimit të kontratave dhe ngjyrosjes së gazoilit në marrjen e vërtetimit të konfirmimit nga IQT) nuk duhet të jetë më shumë se 3 ditë.

4. Me marrjen e këtij vërtetimi nga IQT, Organi i Degës Doganore përkatëse lejon importimin dhe realizon hedhjen në qarkullim të lirë të sasisë së importuar.

5. Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve nëpërmjet strukturave kontrolluese bën kontrollë për efekt të zbatimit të kontratave të depozitura nga Subjektet Importuese. Për rastet kur ajo konstaton shkelje të kontratave informon IQT.

6. Inspektorati Qendror Teknik monitoron përdorimin në Shqipëri të sasive të importuara të kësaj lënde djegëse gazoil (diesel).

Në rast, të verifikimit të ndryshimit të destinacionit të përdorimit nga kontrata e shitjes dhe

identifikimit të ndryshimit të destinacionit në tregtim, IQT aplikon masa penalizuese, sekuestron sasinë e importuar, dhe/ose i propozon Ministrin të Ekonomisë Tregtisë dhe Energjitikës heqjen e lejeve të tregtimit.

7. Sasitë e lëndës djegëse gazoil (dizel), që në nomenklaturën e mallrave përshkruhet në kodin 27101945 dhe që plotëson kërkesat e standardit SSH 31:1997, të cilat janë importuar para datës 1 janar 2009 dhe janë gjendje në magazinat doganore apo pikat e depozitimit dhe tregtimit, lejohen të tregtohen pa iu nënshtruar kushteve të pikës 1 të këtij udhëzimi, si dhe pa u ngjyrosur.

8. Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I FINANCAVE

Ridvan Bode

MINISTRI I EKONOMISË,
TREGTISË DHE ENERGIJITIKËS

Genc Ruli